

Ndërmarrja Publike Qendrore

Posta e Kosovës Sh.A.

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Dreitorëve të PK Sh.A., e me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira për të krijuar të hyra nga palët/konsumatorët e ndryshëm përmes ofrimit të shërbimit për transferim të parave nga operatorët e licencuar për Postën e Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr këtë:

SHPREHJE TË INTERESIT PËR BASHKËPUNIM

KUSHTET DHE KRITERET E PK SH.A. PËR OFRIMIN E MUNDËSIVE TË BASHKËPUNIMIT PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIT NDËRKOMBETAR TË PARAVE

1. Posta e Kosovës Sh. A. ofron mundësi bashkëpunimi për shërbimet e transferimit ndërkombëtar të parave për të gjitha subjektet e interesuara që janë të licencuara.
2. Posta e Kosovës Sh. A., duke u mbështetur në mundësitë afariste me interes të ndërsjellë për palët e interesuara, e duke marrë për bazë trendet e zhvillimeve në treg, ofron bashkëpunim sipas kriterëve në vijim:

Kriteret	Përqindja e provizionit për PK Sh. A.	E negociueshme	E pa negociueshme
Shtrirja në ZP të PK SH.A.	Numri i ZP	Zonat urbane/jo urbane	

3. Këto kriterë do të prezantohen sipas rregullave të PK Sh.A. me qëllim të sigurimit të mundësive të bashkëpunimit me të gjitha kompanitë e licencuara në Republikën e Kosovës.
4. Posta e Kosovës ofron rrjetin e zyrave postare gjithandej Republikës së Kosovës (150 sosh) të shpërndara në shtatë Regjione, për mundësinë e bashkëpunimit komercial me këta operatorë, gjithnjë duke i respektuar ligjet që e mbulojnë këtë veprimtari, si dhe mundësinë më të favorshme komerciale nga ky aktivitet biznesor.

Për: Konsumatorët/Operatorin Ekonomik

1. KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Një (1) vjeçare, me mundësi vazhdimi për periudhën vijuese.

2. PAGESA E KOMISIONEVE – SLA

Nga provizioni i përgjithshëm i paguar nga Klienti, pagesa e Komisionit (SLA) **e negociueshme** të realizuara nga çdo transaksion që administrohet nga PK-ja.

3. USHTRIMI I VEPRIMTARISË SË OPERATORËVE

Operatorët duhet ta respektojnë distancën prej **100 m** në perimetër për hapjen e zyrave të tyre shitëse në afërsi të Zyrave Postare, ku do të ofrohet veprimtaria e njëjtë e këtyre shërbimeve – transferimet e parave nga Operatorët në fjalë.

4. SOFTUERËT, FORMULARËT DHE TRAJNIMET

Operatorët ekonomik, për ushtrimin e veprimtarisë, do të sjellin dhe do t'i instalojnë të gjitha aplikacionet e TI-së falas në PK Sh. A., si dhe do ta bëjnë trajnimin e stafit falas. Po ashtu do të sigurojnë formularët përkatës të shërbimit për dërgimin e vlerave monetare të iniciuara në ndonjë zyrë postare, si dhe për tërheqjen e vlerave monetare nga zyra postare dhe tarifatat-çmimet e shërbimit.

OE obligohet të autorizojë personat përgjegjës rreth qasjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të TI-së dhe aplikacioneve në funksion.

5. Licenca për transferim të parave

Operatori ekonomik duhet të posedojë dhe ta prezantojë licencën për ushtrimin e veprimtarisë “Transferim i parave në Kosovë”.

Gjithashtu duhet të sigurojë lejen e veprimit-licencën për numrin e operatorëve në rrjetin postar.

6. MARKETINGU & MATERIALI NË ZP

Operatori Ekonomik duhet të zhvillojë dhe mbulojë tregun me:

- Marketing në media elektronike – Reklama televizive
- Shenja (reklama) për çdo lokacion
- Shenjë ndriçuese, 2 fletë-ngjitëse, 2 pllakate (posterë), 1 shpërndarës fletushkash, varësisht nga kushtet juridike dhe aprovimi nga ana e KE i PK Sh.A.
- Etj.

T'i dorëzohet:

1X Arkivit Qendror

1X ZKFTH

1X Departamentit të Prokurimit

1x Drejtorisë Operative

1x Drejtoria për Çështje Ligjore

1X DShPKK

Sejdi Hoxha

Kryeshef Ekzekutiv i PK SH.A.